



POLITIKA PËR KUALITET DHE MJEDIS JETËSOR

ADING SHA është përcaktuar për këtë "Politikë për kualitet dhe mjedis jetësor" për të siguruar që prodhimet dhe shërbimet që i ofron t'i plotësojnë nevojat reale të shprehura nga konsumatorët, kriteret ekzistuese ligjore, standardet dhe aktet tjera, si dhe të dëshmojë përkushtimin e vet në mbrojtjen e mjedisit jetësor, që përfshin parandalimin e ndotjes dhe formave të tjera të kujdesit.

Orientimi dhe qëllimi i **ADING SHA**-së, përveç tregut maqedonas, është që të jetë dhe të mbetet lider në tregun e Evropës Juglindore dhe konkurrues në mbarë botën në ofrimin e prodhimeve dhe shërbimeve cilësore në ndërtimtari: për materialet plotësuese (aditivët) për beton dhe llaç, ngjitëset ndërtimore, materiale sanuese (meremetuese), dysheme (shtresa bazike) industriale, mbrojtje nga zjarri të konstruksioneve të çelikut dhe kabllave elektrike, dylle për nyjëzim/fuga (të ngurtë dhe elastikë), lysterë (llaqe) të rezistueshëm dhe përzierje/brumëra.

Këtë qëllim **ADING SHA** e realizon nëpërmjet zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve për menaxhment me kualitetin dhe mjedisin jetësor, të harmonizuar me kërkesat dhe standardet **ISO 9001:2015** dhe **ISO 14001:2015**, që përfshin:

-  Përcaktimi dhe drejtimi i proceseve që ndikojnë për kënaqësinë e shfrytëzuesve dhe palëve të interesuara dhe zbatimin e masave për shtimin e tyre;
-  Realizimi i rolit udhëheqës të menaxhmentit (drejtuesve);
-  Pjesëmarrje aktive e të punësuarve në planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e të gjitha aktiviteteve në procesin e realizimit të prodhimeve, shërbimeve dhe aktiviteteve për mjedisin jetësor;
-  Identifikimi, vërtetimi dhe menaxhimi me proceset dhe burimet (resurset) e nevojshme për zbatimin, mirëmbajtjen, dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhmentit me cilësinë e mjedisit jetësor;
-  Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së prodhimeve, shërbimeve dhe proceseve të tyre;
-  Përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve teknologjike me qëllim të pengimit dhe të ndikimit të proceseve të dëmshme në mjedisin jetësor;
-  Kursimi i burimeve natyrore dhe energjisë për shpenzimin e tyre të kontrolluar dhe racional;
-  Pengimi i përdorimit të materialeve të rrezikshme dhe të dëmshme me substanca të materialeve ekologjike;
-  Vendosija në bazë të të dhënave të mbledhura dhe analizuara;
-  Zhvillimi i marrëdhënieve partnerike me porositësit;
-  Modernizimi i përhershëm i pajisjeve, sistemeve të informimit dhe stërvitja e të punësuarve sipas kompetencave të tyre profesionale, dijes dhe përvojës me anë të edukimit të tyre në të gjitha nivelet;
-  Përkushtim në përmbushjen e obligimeve të tyre në harmoni me kërkesat e mjedisit jetësor;

Sigurimi i cilësisë dhe angazhimit permanent për rritjen e vetëdijes për cilësi dhe mjedis jetësor në të gjitha nivelet paraqet prioritet dhe detyrë e vazhdueshme e udhëheqësisë (menaxhmentit) dhe të secilit të punësuar.

Shkup, janar 2018

Drejtör i Përgjithshëm i **ADING SHA**

Bllagoj Donçev, inxh.i dipl. i ndërt.